



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 82, datë 30.03.2023



PËR

**MIRATIMIN NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 34, DATË 09.05.2022 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR. 4, RRUGA “ALEKSANDËR GOGA” PALLATI NR. 122, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019**

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësine Administrative nr. 4, rruga “Aleksandër Goga”, pallati nr. 122, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Urdhërit nr. 135, datë 01.03.2021 të kryetares së Bashkisë “Për ngritjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 të aplikantëve jofitues që nuk janë përzgjedhur nga programet e procesit të rindërtimit me nivel dëmi

DS4-DS5” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 4, rruga “Aleksandër Goga”, pallati nr. 122, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.
2. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 09.05.2022 përsa i përket klasifikimit si përfitues të z. Dhimitraq Dhrami në masën e strukturës së njësisë së banimit nga 2+1 në 3+1, sipas relacionit hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave DS4-DS5 Bashkia Durrës.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

Ani Dyrmishi



**U shpall sot me datë 03.04.2023**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 232/prot.  
F

Durrës, më 06 . 04 .2023

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.82 datë 30.03.2023 “Për miratimin ndryshimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 34, datë 09.05.2022 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit në njësinë administrative nr. 4, rruga “Aleksandër Goga” pallati nr. 122, i dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karakter individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

